



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kryetarja e Komunës

01nr _____

Dt: 01.10.2015

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 13 dhe 58.a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 8,9,10 dhe 16.1 të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për subvencioneve komunale, si dhe në harmoni me përfundimin 01 nr.06-54059-6/1 i miratuar në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të mbajtur me dt:14.08.2015, me të cilin është miratuar kërkesa e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, për subvencionimin e sektorit të pemëtarisë, të Komunës së Gjakovës me fidanë të mollës dhe kumbullës, me dt: 01.10.2015 e miraton këtë:

V E N D I M

1. Lejohet subvencionimi i projektit të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural për mbështetje financiare të sektorit të pemëtarisë në Komunën e Gjakovës, për sigurimin dhe shpërndarjen e fidanëve të mollës dhe kumbullës, duke e mbështetur këtë projekt me subvencione të DBPZHR në vlerë prej 5,968.80€

2. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të realizon procesin e zotimit të mjeteve financiare në vlerën prej 5,968.80€, nga mjetet e subvencioneve e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, me të cilat do të mundësohet realizimi i obligimeve të Komunës së Gjakovës sipas kontratës me operatorin ekonomik NPT fidanishta “Garden” & NPT “Freskia” me seli në Planqor të Komunës së Gjakovës, me nr. të kontratës 062 të dt: 05.11.2014 dhe transferimin e vlerës prej 5,968.80€ në xhirollogarinë e operatorit ekonomik në PCB nr. 11401661811000176

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë .

4. Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural
- NPT “Garden” & NPT “Freskia” me seli në Planqor
- Arkivit

Kryetarja e Komunës,

Znj. Mimoza Kusari-Lila